FORMATI MARC

TË KUPTUARIT E NJËSIVE TË AUTORIZUARA

Prishtinë
2006

Formati MARC: të kuptuarit e njësive të autorizuara

Titulli i origjinalit:
Understading MARC authority records
Prepared by ntwork Development and MARC Standards Office, Library of Congress, 2 nd ed.

Published by the Cataloging
Distribution Service, Library of Congress
© 2004 The Library of Congress

Botues:

Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës

Kryeredaktor i botimeve:
Dr. Sali Bashota

Përkthyes:
Besim J. Kokollari

Redaktor:
Fazli Gajraku

Dizajni dhe realizimi kompjuterik:
Hekuran Rexhepi

Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës

Botime të veçanta: Formati MARC; 6

Formati MARC: të kuptuarit e njësive të autorizuara

Përktheu
Besim J. Kokollari

Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës
Prishtinë
2006

Acknowledgement

This booklet would have not been translated without the help and encouragement of my Professor James R. Kelly, Humanities Bibliographer at Umass, Amherst, who taught me the course of Cataloging in GSLIS Simmons in Boston.

Mirënjohje

Kjo broshurë nuk do të përkthehej pa ndihmën dhe kurajën që ka dhënë profesori im James R. Kelly, bibliograf i Shkencave Humanitare në Universitetin e Masachussetts në Amherst, te i cili vijova ligjeratat për përshkrimin bibliografik në lëndën e katalogimit në Kolexhin Simmons për studime pasuniversitare në Shkencën e Bibliotekarisë në Boston.

Ky libër është për nevoja arsimore në fushën e bibliotekarisë

Të kuptuarit e njësive të autorizuara në formatin MARC: Katalogimi i lexueshëm nga makina

Për strukturën i këtij dokumenti dhe përshkrimin e përgjithshëm të formatit MARC 21 ka shërbyer si bazë dokumenti *Të kuptuarit e formatit MARC për njësi* bibliografike, të cilin e ka përgatitur fillimisht në vitin 1988 Betty Furrie, në bashkëpunim me Departamentin e bazave të të dhënave të Kompanisë softverike Follett, ndërsa tash mirëmbahet nga Zyra për standarde të zhvillimit të rrjeteve kompjuterike dhe të formatit MARC të Bibliotekës së Kongresit.

E gjithë përmbajtja e njësive të autorizuara në formatin MARC 21 është zhvilluar dhe shkruar nga Zyra për standarde të zhvillimit të rrjeteve kompjuterike dhe e formatit MARC të Bibliotekës së Kongresit.

E botuar nga Shërbimi i shpërndarjes së njësive kataloguese, Biblioteka e Kongresit.

E ofruar nga Biblioteka e Kongresit
Shërbimi i shpërndarjes së njësive kataloguese,
Seksioni i shërbimeve për konsumator Washington, DC 20541-4912
1-800-255-3666
http://www.loc.gov/cds.

Copyright © 2004 Biblioteka e Kongresit, përveç brenda ShBA-së. Në rast të shfrytëzimit të këtij informacioni, të citohet ky material.

PËRMBAJTJA

Çka nënkuptojmë me formatin MARC, dhe pse është i rëndësishëm?

Pjesa I: Çka nënkuptojmë me formatin MARC? 8
Pjesa II: Pse na duhen njësitë në formatin MARC? 11
Pjesa III: Kuptimi i terminologjisë në formatin MARC dhe definicioni i tyre 14
Pjesa IV: Çka nënkuptojmë me njësi të autorizuar në formatin MARC? 16
Pjesa V: A mund t'i shkëmbejmë mes vete njësitë e autorizuara në formatin MARC? 21
Pjesa VI: Çështje lidhur me të dhënat në formatin MARC 23
Pjesa VII: Përfundim 24

Materiale shtesë për formatin MARC 21 25
Pjesa VIII: Përmbledhje e fushave të cilat përdoren më së shpeshti në njësitë e autorizuara të formatit MARC 21 25
Pjesa IX: Lista e disa fushave të tjera që hasen shpesh në njësitë e autorizuar të formatit MARC 21 33
Pjesa X: Numri udhëheqës 33
Pjesa XI: Fusha 008 34
Pjesa XII: Njësi shembull 38
Bibliografi e përzgjedhur 44
Botime të përzgjedhura të Shërbimit për katalogim dhe shpërndarje të Bibliotekës së Kongresit 44
Treguesit e përmbajtjes të MARC 21: Përsëritje 46
Përgjigjet e pyetjeve për treguesit e përmbajtjes në MARC 21: Përsëritje 46

«ÍÀSHTÀ NJÀSIA NÀ FORMATIN MARC, DHE PSE ÀSHTÀ E RÀNDÀSISHME?

Sot është e pamundur që të lexohet një revistë biblioteke, të marrësh pjesë në një konferencë për biblioteka, apo edhe vetëm të kesh një bisedë të zakonshme me kolegët e tjerë bibliotekarë dhe të mos dëgjosh shprehjet "formati MARC", "njësitë në formatin MARC", apo edhe "përputhshmëria e formatit MARC me formatet e tjera."Shumë biblioteka nuk kanë pasur ende mundësi që personeli i tyre të ndjekë kurse të rregullta në të cilën do të mësonin për tema të rëndësishme të automatizimit të bibliotekave dhe rolin e formatit MARC në këtë proces, pasi dihet që sistemet e automatizuara janë pjesë e rëndësishme në biblioteka.

Ky dokument do të shpjegojë – sa më thjesht që është e mundur – kuptimin se çfarë është një njësi në formatin MARC, si dhe do të japë informacione themelore për ta kuptuar dhe vlerësuar një njësi të autorizuar në formatin MARC. Ndërsa dokumenti tjetër "Të kuptuarit e formatit MARC për njësi bibliografike" shtjellon kuptimin e njësive bibliografike në formatin MARC.

PJESA I:

ÇKA NËNKUPTOJMË ME FORMATIN MARC?

Ç'është njësia në formatin MARC (lexo: mark)?
Me njësi në formatin MARC nënkuptojmë njësi kataloguese të lexueshme nga makina (kompjuteri).
Atëherë çfarë nënkuptojmë me njësi kataloguese e lexueshme nga makina?
Të lexueshme nga makina: Me "të lexueshëm nga makina" nënkuptojmë se një lloj i makinës, për shembull kompjuteri, mund t'i lexojë dhe interpretojë të dhënat në një njësi të katalogimit. Në faqet në vijim do të japim shpjegime se ku qëndron rëndësia e kësaj dhe si është një gjë e tillë e mundur.
Njësi kataloguese: Njësitë kataloguese janë dy llojesh: 1) *Njësi bibliografike*, të cilat përmbajnë informacione për librin, periodikun, incizimin zanor, videon, etj., dhe 2) *Njësi të autorizuara*, të cilat përmbajnë forma e trajta të autorizuara të emrave, titujve, dhe lëndëve të cilat përdoren në njësitë bibliografike dhe ofrojnë referenca kryqësore në katalog. Dokumenti "Të kuptuarit e formatit MARC për njësi bibliografike" e përshkruan llojin e parë, e ndërsa ky dokument e përshkruan llojin e dytë.
Njësitë e autorizuara në formatin MARC: Njësitë e autorizuara në formatin MARC përmbajnë forma të standardizuara të emrave të njerëzve, emra të korporatave (për shembull, të shoqatave, bizneseve, institucioneve, etj.), të takimeve, të titujve, dhe lëndëve. Duke i krijuar të tërë këto, njësitë e autorizuara ofrojnë kontroll të standardizuar. Kontroll i standardizuar do të thotë krijimi i një formë standarde të një emri dhe përdorimi i asaj forme kurdoherë që ai emër përdoret si përcaktuese në njësitë bibliografike.
Për shembull, po qe se do të kërkonit në katalogun elektronik, librin "Aventurat e Tom Sojerit," të Mark Tuenit (Në anglisht titulli: Adventures of Tom Sawyer", dhe emri i autorit: Mark Twain), ju do ta keni këtë rezultat:

TITULLI: The adventures of Tom Sawyer / Mark Twain ; with an introduction by Robert S. Tilton.
AUTORI: Twain, Mark, 1835-1910.
BOTIMI: New York : Signet Classic, [1997]
PËRSHKRIMI FIZIK: xxi, 216 f. ; 18 cm.
SHËNIMET: Ka bibliografi (f. 213-216)
LËNDA: Sawyer, Tom (Fictitious character) - Fiction.
Boys - Missouri - Fiction. Mississippi River - Fiction. Missouri - Fiction.
Adventure stories.

Përcaktuesja e AUTORIT dhe përcaktueset LËNDORE (të nënvizuara më lartë me ngjyrë) janë forma të kontrolluara dhe të standardizuara të emrit dhe të lëndëve. Ato ruhen në vende të ndryshme në njësitë e autorizuara dhe përdoren si përcaktuese dhe pika qasjeje në njësitë bibliografike.

Pa kontroll të autorizuar, gjetja e librave të ndryshëm në një katalog të madh të një biblioteke do të ishte si të gjeje gjilpërën në kashtë!

Është me rëndësi të theksohet se formulimi i një përcaktuese lëndore apo emri në njësitë e autorizuara mbështetet në principet e përgjithshme dhe të pranuara të katalogimit dhe të ndërtimit të tezaurëve. Njësia e autorizuar në formatin MARC 21 i mban këto përcaktuese që të përdoren në sistemin e bibliotekës, përkatësisht në katalogun e saj. Kështu që, njësitë e autorizuara në formatin MARC 21 nuk paraqesin ndonjë rregull në vete sa i përket formulimit të përcaktueseve lëndorë dhe emrave, por krijimi i tyre mbështetet, siç e kemi cekur më lartë, në rregullat e katalogimit dhe të standardeve të krijimit të tezaurëve.

Është po ashtu me rëndësi se njësitë e autorizuara, jo si njësitë bibliografike, nuk i paraqesin apo përfaqësojnë materialet që gjenden në koleksionin e bibliotekës. Për më tepër, ato janë një mjet të cilin e përdorin bibliotekarët për të arritur sa më shumë standardizim të njësive bibliografike si dhe të ofrojnë një kornizë e cila do t'i lidhte emrat dhe lëndët e ngjashme në një katalog – pra e organizojnë katalogun që t'i ndihmojnë përdoruesit për t'i gjetur burimet e bibliotekës.

Një njësi e autorizuar i përmban tri pjesë themelore:

1) Përcaktueset, 2) Referencat kryqësore, dhe 3) Shënimet. (Njësitë e autorizuara në formatin MARC përmbajnë po ashtu edhe informacione shtesë.) Edhe pse këto pjesë përbërëse janë përshkruar shkurtimisht më poshtë, ato do të diskutohen në tërë tekstin e këtij dokumenti.

1) Përcaktueset: janë forma standarde "të autorizuar" të emrit, lëndës, ose titullit, të cilat përdoret si pika qasjeje – apo përcaktuese – në njësitë bibliografike. Qëllimi i përdorimit të emrave dhe lëndëve të standardizuara në njësitë bibliografike është për të mundësuar nxjerrjen e rezultateve të përbashkëta të njësive bibliografike me elemente të përbashkëta.

2) Referencat kryqëzore: janë referencat të cilat e drejtojnë përdoruesin prej një forme të ndryshme të emrit apo lëndës në formën e autorizuar (kjo po ashtu quhet edhe *shih referencë*) apo prej një forme të autorizuar në një formë tjetër të autorizuar për shkak se janë të lidhura me njëra-tjetrën (*shih po ashtu këtë referencë*). Për njësitë e autorizuara në formatin MARC, referencat gjenden apo në njësinë e përcaktueseve të autorizuara.

SQARIM TERMINOLOGJIE

Një njësi e autorizuar krijohet për një formë të standardizuar të një emri apo termi. Kjo formë quhet shpesh formë e autorizuar apo standarde. Në një njësi të autorizuar, forma standarde është elementi kryesor për të cilën e tërë ajo njësi është krijuar, për këtë arsye ajo quhet përcaktuese.
Në njësitë e autorizuar, format e ndryshme të një përcaktuese të standardizuar mund të kërkohen (d.m.th. janë të regjistruara). Në njësit e autorizuara, format e ndryshme shpesh njihen si: shih referencën pasi ato shërbejnë për ta drejtuar përdoruesin e katalogut nga një formë e ndryshme në përcaktuesen e standardizuar.

Po ashtu emra dhe terma të tjerë të standardizuar janë të lidhura (të ngjashëm) me përcaktuesen e standardizuar (për të cilën është krijuar njësia) mund të kërkohen (d.m.th. janë të regjistruara) në njësinë e autorizuar. Në njësinë e autorizuar ato shpesh njihen me emrin: shih po ashtu këtë referencë, pasi që përdoren për ta drejtuar përdoruesin nga një emër, term apo koncept po thuajse i ngjashëm te përcaktuesja e standardizuar. Por, mbani mend që emrat dhe termat e ngjashëm janë po ashtu forma më vete të standardizuara kështu që edhe ato janë përcaktuese të standardizuara në njësitë e tyre të autorizuara.
Për ta përmbledhur, njësia e autorizuar përmban:
Përcaktuesen e standardizuar
Format e ndryshme të emrit (emrave) ose termit (termave – lëndëve) (shih këtë referencë)
Format që kanë lidhje me emrin (emrat) ose termin (termat) (shih po ashtu këtë referencë)
Informacioni në njësinë e autorizuar përdoret për të krijuar pamjen vijuese në katalogun publik:
Formën e ndryshme të emrit ose termit
Shih përcaktuesen standarde
Emri ose termi që ka lidhje me përcaktuesen kryesore
Shih po ashtu këtë përcaktuese standarde
Konfigurimi i njësisë së autorizuar për t'i përfshirë referencat dhe për t'i bërë ato funksionale është një teknikë e dobishme për plotësimin e të dhënave të nevojshme për një kontroll të autorizuar. Në mënyrë të suksesshme e shpie përdoruesin te materiali i nevojshëm duke përdorur një mori emrash e termash të paraqitur në trajta të ndryshme.

3) Shënimet: janë shënime të cilat përmbajnë informacione të përgjithshme për përcaktueset e autorizuara apo edhe informacione më të veçanta, si citate të një burimi të konsultuar në të cilin mund ta gjejmë ose mos ta gjejmë informacionin për atë përcaktuese.
Si shembull për përdorimin e përcaktueseve të autorizuara në njësitë kataloguese është ajo për shkrimtaren e njohur franceze, George Sand (Xhorxh Send). Përdoruesit mund ta kërkojnë atë në katalog ose duke e njohur emrin e saj të vërtetë, Amadine Aurore Lucie Dupin, ose duke e njohur pseudonimin e saj, George Sand. Njësia e autorizuar siguron që të gjitha njësitë bibliografike në të cilat gjendet emri të përdorin emrin e saj më popullor, d.m.th. atë që ka shtrirje më të madhe, kështu që të gjitha veprat e saja të mund të gjendet nën një kërkim të vetëm sipas cilësdo formë të emrit të saj – dhe se ekziston referenca kryqëzore në katalog për format e tjera të emrit të saj, së bashku të përdorura apo të papërdorura. Referencat kryqëzore i mundësojnë - ose përdoruesit që ta ndryshojë kërkimin në një formë më të saktë - ose sistemit që të bëjë këtë kërkim në mënyrë automatike.

Pjesa II

PSE NA DUHEN NJËSITË NË FORMATIN MARC?

Pse kompjuteri nuk mund t'i lexojë njësitë e autorizuara të krijuara në skeda?

Informacioni i njësive të autorizuara të krijuara në skeda letre nuk mund të futet thjesht në kompjuter dhe të bëhen menjëherë pjese a katalogut të automatizuar. Kompjuteri ka nevojë për metoda dhe mënyra me anë të të cilave i interpreton informacionet që gjenden në një skedë letre të një njësie të autorizuar. Njësitë në formatin MARC përmbajnë një udhërrëfyes të interpretimit të të dhënave të krijuar në të, të njohura si "shenja orientuese", para secilës pjesë (element) të informacioneve të një njësie të autorizuar.

Vendi në të cilën vendoset secila pjesë e njësive të autorizuara (përcaktueset, referencat kryqëzore dhe shënimet) quhet "fushë." Struktura e formatit MARC mundëson që një njësi të ketë një numër të pakufizuar të fushave si dhe gjatësi për të mbajtur informacione të jetë e pakufizuar. Kjo lloj mundësie është e nevojshme për shkak se, p.sh., jo të gjitha përcaktueset janë të gjatësisë së njëjtë ("Plato" kundrejt "Kennedy, Albert J. (Albert Joseph), 1879-1968").

Kompjuteri nuk mund të hamend se një lloj i caktuar i informacionit fillon dhe mbaron në pozitë të njëjtë në çdo njësi të autorizuar. Për shembull, një *shih po ashtu këtë referencë* nuk fillon gjithmonë në pozitën e 220 të një njësie dhe të mbaron pastaj në pozitën e 248. Prandaj, secila njësi në formatin MARC përmban një "pasqyrë të vogël të përmbajtjes" të formuluar në bazë të standardeve të paracaktuara.

"Shenjat orientuese" të informacioneve: Kompjuterit duhet t'i ofrohet ndihmë nëse dëshirojmë që ai t'i lexon dhe interpreton si duhet njësitë e autorizuara të krijuara në formatin MARC. Tabela e mëposhtme e tregon informacionin që këto "shenja orientuese" duhet ta bartin.

Po që se një njësi e autorizuar është krijuar si duhet dhe është ruajtur në kompjuter, atëherë mund të krijohen dhe shkruhen programe kompjuterike të cilat mund ta shfaqin informacionin ashtu si duhet në ekran të kompjuterit. Po ashtu mund të krijohen programe të ndryshme të cilat do të mundësojnë kërkimin dhe nxjerrjen e rezultateve për lloje të caktuara të informacioneve brenda fushave specifike. Programet kompjuterike mund të shfaqin po ashtu edhe lista të përcaktueseve e referencave, të cilat i përmbushin kriteret e caktuara të një kërkimi të veçantë.

Njësi me "shenja orientuese" në formë teksti

"Shenjat orientuese"	Informacioni
Hapësira e përcaktueses Emri: Data(t):	 King, Stephen, 1947-
Hapësira shih referencën Emri: Data(t):	 King, Stiven, 1947-
Hapësira shih po ashtu këtë referencë Emri: Data(t):	 Bachman, Richard, 1947-
Hapësira e shënimeve Burimi i citatit: Burimi i citatit: Informacioni u gjend:	 His Carrie, 1974. Washington post, 4ç9ç85 (Stephen King i ka shkruar 5 romane në të cilat e përdor pseudonimin Richard Bachman)

Njësia e njëjtë me tage të formatit MARC

"Shenjat orientuese"		Informacioni
100 1#	$a	King, Stephen,
	$d	1947-
400 1#	$a	King, Stiven,
	$d	1947-
500 1#	$a	Bachman, Richard,
	$d	1947-
670 ##	$a	His Carrie, 1974.
670 ##	$a	Washington post, 4ç9ç85
	$b	(Stephen King i ka shkruar 5 romane, në të cilat e përdor pseudonimin Richard Bachman)

Pse një standard? Ju mund të krijoni metodat tuaja të organizimit të informacioneve të njësive të autorizuara, por në atë mënyrë do ta izoloni bibliotekën tuaj, do ta kufizoni mundësitë, si dhe do t'i krijoni vetes suaj shumë më shumë punë. Duke përdorur formatin standard MARC, mundësohet parandalimi i dyfishimit të punës së njëjtë dhe u mundësohet bibliotekave që t'i përdorin informacionet e njëjta të njësive të autorizuara mes tyre.

Përzgjedhja e formatit MARC u mundëson bibliotekave të marrin dhe të përdorin informacionet e njësive të autorizuara të cilat janë të parashikueshme dhe të besueshme. Po që se një bibliotekë do të zhvillonte një sistem "të vetin" që nuk do të përdorte njësitë në formatin MARC, nuk do të paraqiste ndonjë përparësi apo përparim në fushën e industrisë së standardeve, qëllimi i të cilave është komunikimi i informacioneve sa më gjerë që të jetë e mundur.

Përdorimi i formatit MARC u bënë të mundur bibliotekave që të shfrytëzojnë sistemet e automatizuara bibliotekare, të cilat shërbejnë për menaxhimin e veprimtarisë bibliotekare. Shumica e sistemeve të tilla u përshtaten nevojave të çdo lloj biblioteke dhe janë të projektuara në atë mënyrë që të punojnë me formatin MARC. Këto sisteme mirëmbahen nga shitës të ndryshëm komercial, kështu që bibliotekat mund të përfitojnë nga teknologjia e fundit. Formati standard në MARC po ashtu mundëson që bibliotekat të mund të zëvendësojnë një sistem me një tjetër duke garantuar që informacionet e ruajtura në këtë format të përputhen përsëri me sistemin e ri. Shih pjesën V të këtij dokumenti për më shumë informacione sa i përket rëndësisë dhe përparësive të përdorimit të njësive të autorizuara në formatin MARC.

MARC 21: për shkak që Biblioteka e Kongresit ka koleksione të mëdha, si dhe programe bashkëpunimi me biblioteka të tjera, formati MARC21 shërben si burim kryesor të njësive të autorizuara për katalogët në ShBA dhe në nivel ndërkombëtar. Në kohën kur Biblioteka e Kongresit filloi të përdorte kompjuter në vitet e 1960-ta, ajo e shpiku formatin bibliografik në MARC të Bibliotekës së Kongresit, sistem që përdorte numra të shkurtër, shkronja, dhe simbole brenda vetë njësisë bibliografike për të dalluar lloje të ndryshme të informacioneve brenda asaj njësie. Në vitet e 1970, Biblioteka e Kongresit e krijoi shoqëruesen e saj, formatin MARC të njësive të autorizuara. Formatet e hershme origjinale në MARC u zhvilluan dhe u bënë MARC 21 dhe janë bërë standarde për shumë biblioteka, si për njësi bibliografike edhe për ato të autorizuara. Formati MARC i njësive të autorizuara, si dhe të gjitha dokumentet e tjera zyrtare të formatit MARC 21, mirëmbahen nga Biblioteka e Kongresit. Ajo botohet si *Formati MARC 21 për njësi të autorizuara* (MARC 21 Format for Authority Data).

Krahasimi i njësisë së njëjtë ku paraqitet me tekst dhe me tage në formatin MARC, paraqet një shembull të mirë të përparësive të formatit MARC 21. Këtu kemi të bëjmë me hapësirën që zënë këto informacione në bazën e të dhënave të bibliotekës. Shih tabelat më lart. Formati MARC 21 i përdor taget "670" "$a" dhe "$b" për t'i dalluar fushat veç e veç në vend të ruajtjes së

fjalëve “burimi”, “citati”, “informacioni”, “u gjend”, të cilat i gjejmë në secilën njësi të autorizuar. Ky standardizim mundëson përdorimin më efikas të kompjuterëve duke kursyer sa më shumë hapësirë në të.

Pjesa III

TERMINOLOGJIA NË FORMATIN MARC

Kjo pjesë përmban informacione se si të lexohen, kuptohen dhe përdoren njësitë e autorizuara në formatin MARC. Ka të bëjë me atë se çfarë do të shohin dhe çfarë u nevojitet bibliotekarëve, të cilët e përdorin një sistem të automatizuar bibliotekar për të kuptuar se çfarë ndodh në ekranin e kompjuterit kur ta krijojnë, rishikojnë, apo shikojnë një njësi të autorizuar. Theks i veçantë do t’u kushtohet fushave të cilat përdoren më së shpeshti në njësitë e autorizuara.

Njëra prej tabelave në Pjesën II na tregoi një njësi në MARC me anë të tageve “shenjave orientuese”. Këto “shenja orientuese” më saktë do të ishte t’i quanim *fusha, tage, tregues, nënfusha, kode të nënfushave*, dhe *tregues të përmbajtjes*. Në këtë seksion bëhet fjalë për terminologjinë që e hasim në formatin MARC 21.

1. Fushat janë të shënuara me tage.

Fusha: Secila njësi e autorizuar është e ndarë në mënyrë logjike nëpër fusha. Ekziston një fushë e veçantë për përcaktuesen, fusha për shih referencat, e kështu më radhë. Këto fusha janë të ndara në një apo më shumë “nënfusha.”

Siç e kemi përmendur edhe më herët, emrat e fushave në formë tekstuale janë shumë të gjata për t’u riprodhuar në secilën prej fushave të njësive në formatin MARC. Në vend të tyre ato janë paraqitur me një tag prej tri shifrave. (Edhe pse katalogët në Internet mund t’i shfaqin emrat e fushave, ata emra jepen nga softveri, e jo nga njësitë e formatit MARC.)

Tagu: Secila fushë shoqërohet me një numër 3 shifror të quajtur “tag”. Tagu e identifikon fushën – llojin e informacionit – që pason. Tagu është gjithmonë 3 shifrorë edhe nëse ajo është shfaqur nga ndonjë kompjuterë së bashku me treguesit që vinë pas tyre, menjëherë dhe mund të duket si një numër 4 ose 5-shifror.

Shembulli i mëposhtëm paraqet taget e përdorura në një njësi të autorizuar të emrit personal:

Tagu 100 tregon përcaktuesen kryesore të emrit personal (autorit)
Tagu 400 tregon shih referencën e emrit personal (nëse ka forma të ndryshme)
Tagu 500 tregon shih po ashtu këtë referencë të emrit personal
Tagu 670 tregon burimin se ku është gjetur informacioni

```
100 1#  $a Woolf, Virginia, $d 1882-1941
```

Këtu po japin një shembull të një fushe. Numri 100 është tag, i cili tregon se kjo fushë është për përcaktuesen kryesore të emrit personal.

Shërbimi i shpërndarjes së njësive kataloguese (në origjinal: Cataloging Distribution Service, CDS) të Bibliotekës së Kongresit e mirëmban dhe e shpërndan listën e hollësishme të të gjitha tageve si në dokumentin e plotë "Formati MARC 21 për njësitë e autorizuara" (në origjinal: MARC 21 Format for Authority Data) si dhe në versionin e përmbledhur me titull "Formatet MARC 21" (në origjinal: MARC 21 Concise Formats). Këto dy dokumente ju këshillojmë që t'i keni nëse punoni me njësi të autorizuara. Ato janë dokumente te hollësishme që kanë shumë shembuj. Ky informacion mund të gjendet po ashtu në Internet në: www.loc.gov/marc.

Pas një ekspozimi të shkurtër të formatit MARC 21 të njësive të autorizuara, është përsëri me rëndësi t'i dëgjojmë bibliotekarët duke folur për formatin MARC. Bibliotekarët të cilët punojnë me krijimin e njësive në formatin MARC i mësojnë përmendësh numrat e fushave më të shpeshta, të cilët i përdorin gjatë krijimit të njësive në këtë format.

Një përshkrim i tageve që përdoren më së shpeshti është dhënë në Pjesën VIII të këtij dokumenti. Ndërsa një listë e shkurtër e tageve të tjera është dhënë në Pjesën IX.

2. Disa prej fushave identifikohen edhe më tej prej treguesve.

Treguesit: Dy pozita të cilat shpesh mbushen prej dy shifrave vijnë menjëherë pas secilit tag (me përjashtim të fushave 001 deri 009). Një ose të dy këto pozita mund të përdoren për t'i vendosur "treguesit." Në disa prej fushave përdoret vetëm treguesi i parë ose i dytë; në disa të tjera përdoren të dy treguesit; e në disa fusha, si fusha 010, nuk përdoret asnjë prej treguesve. Në ato raste kur nuk përdoren treguesit në asnjërën prej pozite, ai tregues do të thotë se është "i papërcaktuar" dhe pozita lihet e zbrazët. Në këtë dokument do ta përdorim shenjën "#" për të paraqitur një pozitë të zbrazët apo tregues të papërcaktuar.

Vlera e secilit tregues është një numër prej 0 deri 9. (Edhe pse rregullat shkruajnë se treguesi mund të jetë edhe shkronjë, ato zakonisht nuk përdoren.) Edhe pse treguesit së bashku mund të duken se janë një numër 2 shifror, ato në të vërtetë janë dy numra të ndryshëm veç e veç. Vlerat e treguesve dhe kuptimi i tyre është shpjeguar në dokumentacionin e formatit MARC 21. Në shembullin e më poshtëm, dy numrat që vijnë menjëherë pas tagut 100 (numri 3 dhe shenja #) paraqesin tregues me vlerë të caktuar. Treshi është treguesi i parë. Shenja # është treguesi i dytë.

Vlera 3 e *treguesit të parë* të përdorur në fushën e përcaktueses kryesore të emrit personal tregon se informacioni është emër familje, e jo emër personal i një individi. Vlera e treguesit të

```
100 3#  $a Guelf, House of
```

dytë në fushën 100 është e papërcaktuar tani për tani, dhe për këtë arsye mban shenjën "#."

3. Nënfushat identifikohen me kode të nënfushave dhe dilimetra.

Nënfusha: Shumica e fushave përmbajnë pjesë të ndryshme të informacionit të lidhura me njëra-tjetrën. Secili lloj i informacionit brenda një fushe quhet nënfushë, dhe secilës nënfushë i paraprinë një kombinim i dilimetrit dhe kodit të nënfushës. Fushat prej 001 deri 009 nuk kanë nënfusha.

Për shembull, fusha për përcaktuesen e emrit personal e ka një nënfushë, mes të tjerash, për emrin personal, numërimin,

```
100 0#  $a Gustaf
        $b V,
        $c King of Sweden,
        $d 1858-1950
```

titujt dhe datën lidhur me emrin.

Kodi i nënfushës: Kodet e nënfushave shprehen me shkronja të vogla (e nganjëherë edhe me një numër) të paraprirë nga një delimetër. Dilimetri është një shenjë që shërben për t'i ndarë nënfushat nga njëra-tjetra. Secili kod i nënfushës tregon se çfarë lloj informacioni ka aty. (Dokumentacioni për formatin MARC 21 të njësive të autorizuara i shpjegon të gjitha kodet valide të nënfushave.)

Në shembullin e mësipërm, kodet e nënfushave janë $a për emrin personal, $b për numërimin, $c për titullin dhe fjalët e tjera që e shoqërojnë emrin, dhe $d për datën që e shoqëron emrin.

Dilimetri: Programet e ndryshme kompjuterike përdorin shenja të ndryshme për të shfaqur dilimetrin në ekran të kompjuterit. Për shembull përdoren shenjat (), (@), ($), (_), apo edhe "". Në këtë botim do të përdoret shenja e dollarit ($) si dilimetër që paraqet një pjesë të kodit të nënfushës.

4. Treguesit e përmbajtjes - është një term i gjerë që u referehet kodeve të tageve, treguesve, dhe nënfushave.

Të tri llojet e treguesit të përmbajtjes – taget, treguesit, dhe kodet e nënfushave – janë kryesorët në sistemin e formatit MARC 21. Në librin e tij, *Formati MARC për përdorim në biblioteka (botimi i dytë (Boston: G.K.Hall & Co., 1989) f. 5)* (në origjinal: MARC for Library Use), Walt CraWford e quan sistemin e formatit MARC një sistem "i cili përdor shenja-simbole". Të tri llojet e treguesve të përmbajtjes janë simbole të shkurtra, të cilat i emërtojnë dhe shpjegojnë njësitë e autorizuara.

Pjesa IV

ÇKA NËNKUPTOJMË ME NJËSI TË AUTORIZUAR NË FORMATIN MARC?

1. Përmbajtja e njësisë së autorizuar.

Përcaktueset

Për secilën formë të autorizuar të përcaktueseve krijohet një njësi e autorizuar. Njësitë e autorizuara të emrave të

Bibliotekës së Kongresit është një ndër listat më të mëdha të njësive të autorizuara të përdorura gjerësisht. Kjo listë të dhënash është përdorur edhe në këtë dokument. Kjo listë mund të merret e plotë nga Shërbimi i shpërndarjes së njësive kataloguese të Bibliotekës së Kongresit, ose edhe mund ta kërkoni pa pagesë në Internet në: http://authorities.loc.gov. Po ashtu, edhe për emrat gjeografik dhe të përcaktuesve lëndorë përdoret lista e njësive të autorizuar të Bibliotekës së Kongresit, të cilën mund ta gjeni si në formë të shtypur ashtu edhe elektronike nga Shërbimi i shpërndarjes së njësive kataloguese. Ekzistojnë po ashtu edhe lista të tjera si Lista e përcaktuesve lëndorë Sears dhe Tezauri i artit dhe arkitekturës. Forma e një përcaktuese lëndore duhet të jetë në njërën prej këtyre listave ose të ndiqen rregullat e tyre për krijimin e një të reje.

Të gjitha këto përcaktuese janë të këtyre llojeve: emra, kombinim emri/titulli, tituj uniform, ose lëndë. Shembuj të përcaktueseve të emrave përfshijnë:

```
100 1#  $a Woolf, Virginia, $d 1882-1941 (përcaktuese e emrit personal)
110 20  $a Association for Childhood Education International (përcaktuese e emrit të korporatës)
111 20  $a La Crosse Health and Sports Science Symposium (përcaktuese e emrit të takimit)
151 ##  $a Mexico (përcaktuese e emrit gjeografik)
```

Një *përcaktuese emër* mund të jetë emër personal, korporate, takimi (konference), juridiksioni (duke përfshirë edhe emrat gjeografik).

Përcaktuesja *emër/titull* përbëhet prej emrit dhe titullit të veprës. Pjesa e emrit përmban emër personal, të korporatës, takimit, ose të juridiksionit. Pjesa e titullit përmban titullin përmes të cilit një njësi apo seri identifikohet për qëllime të katalogimit. Kjo vlen posaçërisht për veprat klasike, të cilët gjatë kohërave të ndryshme janë botuar nën tituj të ndryshëm. Një shembull i përcaktueses emër/titull është:

```
100 1#  $a Dostoyevsky, Fyodor,
        $d 1821-1881.
        $t Crime and punishment.
```

Përcaktuesja e *titullit uniform* përbëhet prej një titulli, i cili nuk shoqërohet nga ndonjë autor. Një shembull për këtë lloj përcaktuese është:

```
130 #0  $a Bible. $l Latin. $s Vulgate
```

Një *përcaktuese lëndore* mund të jetë një fjalë e vetme, apo një grup fjalësh. Tagu për lëndën mbështetet në fjalën e parë ose në togfjalëshin e parë të përcaktueses – tematike, zhanrit/formës, gjeografike, kronologjike, emër personal, emër korporate, emër takimi (konference),

ose titull. Fjalët e tjera në përcaktuese janë të vendosura në nënfusha të veçantë të cilat i quajmë nëndarje.

```
100 1#  $a Shakespeare, William.
        $d 1564-1616.
        $x Criticism and interpre-
           tation $x History
        $y 18th century
150 ##  $a Books and reading
        $z Argentina
```

Referencat e kontrolluara

Njësitë e autorizuara në formatin MARC 21 i përfshijnë dy lloje referencash kryqëzore, të cilat ose e drejtojnë përdoruesin nga një përcaktuese e paautorizuar në përcaktuesen e autorizuar (këto i quajmë "shih referencën" dhe vendosen në taget 4XX) ose nga një përcaktuese e autorizuar në përcaktuesen tjetër po ashtu të autorizuar (këto i quajmë "shih po ashtu këtë referencë" dhe vendosen në taget 5XX). Megjithatë, referencat kryqëzore nuk paraqiten shumë qartë në njësitë e autorizuar. Mirëpo, forma të ndryshme të përcaktueseve, të cilat janë të ndërlidhura kontrollohen në njësinë e autorizuar, të cilat i referohen formës së autorizuar. Moskrijimi i njësive të veçanta për referencat kryqëzore, por kontrollimi i tyre në njësinë e autorizuar, ku është vendosur edhe forma standarde, bën të mundur shfaqjen e informacioneve të autorizuar në mënyrë të duhur në katalog – dhe përdoruesi e sheh informacionin në formën më të përshtatshme për të. Shfaqja e referencave kryqëzore mund të gjenerohet nga sistemet në atë formë që e kombinon përmbajtjen e një fushe të referencës kryqëzore të kontrolluar dhe fushën e përcaktueses kryesore në 1XX të asaj njësie.

Informacioni i njësisë së autorizuar:

```
100 1#  $a Twain, Mark, $d 1835-1910
        [Përcaktuesja e standardizuar]
400 1#  $a Conte, Louis de, $d 1835-1910
        [Shih referencën]
500 1#  $a Clemens, Samuel
        Langhorne, $d 1835-1910
        [Shih po ashtu këtë referencë]
```

Mënyra se si shfaqet njësia e mësipërme në ekranin e kompjuterit:

```
Twain, Mark, 1835-1910
Shih po ashtu: Clements, Samuel
                 Langhorne, 1835-1910
               Clemens, Samuel
               Langhorne, 1835-1910
Shih po ashtu: Twain, Mark, 1835-1910
               Conte, Louis de, 1835-1910
Shih: Twain, Mark, 1835-1910
```

Shënimet

Njësia e autorizuar në MARC 21 mund të ketë edhe shënime po ashtu. Këto shënime mund të shfaqen si në katalogun publik, po ashtu mund të kufizohen të mos shfaqen fare, por të përdoren vetëm nga bibliotekarët si udhëzim në punën e tyre.

Informacion i njësisë së autorizuar:
670 ## $a Informacioni i marrë përmes telefonatës në Zyrën Kombëtare të regjistrimit të vendeve historike
[Shënim që shërben për katalogim]
680 ## $i Ndërhyrja kirurgjike e kryer brenda dite. Mund të ketë ndodhur në spital apo edhe të jetë kryer në ndonjë zyre, apo qendër kirurgjike.
[Shënim që shërben për informacion në katalogun publik]

2. Përbërësit struktural të njësive të autorizuara.

Ashtu si njësitë bibliografike në formatin MARC 21, edhe njësitë e autorizuara në MARC 21 përbëhen prej tre pjesëve kryesore: Numri udhëheqës (në origjinal në anglisht: the Leader), Numri orientues (në origjinal në anglisht: directory), dhe Fushat variabël.

Numri udhëheqës përmban informacione, që nevojiten për përpunimin e njësisë. Elementet me informacione përmbajnë vlera numerike dhe kode dhe identifikohen përmes pozitës të cilën e zënë në njësi. Numri udhëheqës i zë plot 24 pozita dhe renditet i pari në njësinë e autorizuar MARC 21. Shumica e informacionit në Numrin udhëheqës shërben për kompjuterin që ai ta lexojë dhe përpunojë njësinë. Shih pjesën X për më shumë informacione lidhur me Numrin udhëheqës.

Numri orientues është një varg përcaktuesish shifror të përbërë prej tagut, gjatësisë, dhe pozitës filluese ku nis secila fushë variabël brenda asaj njësie. Secila përcaktuese në Numrin orientues është 12 pozita i gjatë. Numrin orientues e gjeneron gjithmonë kompjuteri. Shih pjesën XII për më shumë hollësi lidhur me Numrin orientues.

Fushat variabël identifikohen me një tag tre shifror, i cili ruhet në numrin orientues si përcaktuese për secilën fushë variabël. Secila fushë përfundon me një shifër, e cila e mbyll fushën. Pjesa VIII i përshkruan fushat më të shprehura variabël.

Është me rëndësi të cekim se ekzistojnë dy lloje të fushave variabël. Fushat variabël të kontrollit janë ato që gjenden në fushat 00X. Edhe pse këto fusha identifikohen me një tag të fushës në Numrin orientues, ato prapë se prapë nuk kanë ndonjë pozitë të ndarë për tregues apo për kode të nënfushave. Mirëpo, ato mund të kenë vetëm një element informacioni, ose një varg të elementeve të informacioneve me gjatësi fikse të identifikuar në bazë të pozitës që zënë. Për shembull, fushës 008 i referohemi si Elemente informacionesh me gjatësi fikse, apo Kode të fushave fikse. 40 pozitat që zë kjo fushë përmbajnë informacione të rëndësishme, por në formë të shkurtuar. Të dhënat në këtë fushë përdoren për të identifikuar dhe nxjerrë njësi të cilat përkojnë me kritere të veçanta. Pjesa XI jep më shumë shpjegime sa i

përket fushës 008. Shembulli pasues e ilustron fushën variabël fikse 008:

```
008 860107in#acannaaan##########sa#ana######u
```

Fushat variabël me informacione, në anën tjetër, i kanë dy pozita të rezervuara për treguesit në fillim të secilës fushë së bashku me dy shifra për kodin e nënfushës që iu paraprijnë secilit element të informacionit brenda një fushe. Më poshtë po japim një shembull të fushë variabël 100 (Fusha e përcaktueses kryesore për emër personal):

```
100 1#  $a Cameron, Simon, $d 1799-1889
```

Fushat variabël me informacione janë të organizuara në grupe në bazë të shifrës së parë të tagut, i cili e identifikon funksionin e informacionit brenda fushës. Llojin e informacionit që gjendet në fushë e identifikon pjesa tjetër e tagut (dy shifrat e tjera). Këto grupe janë:

0XX Numrat standard, numrat e klasifikimit, kodet
1XX Përcaktueset (të autorizuar dhe referencat)
2XX Shih referencën (komplekse)
3XX Shih po ashtu këtë referencë (komplekse)
4XX Shih referencën
5XX Shih po ashtu këtë referencë
6XX Shënimet
7XX Përcaktueset lidhëse
8XX Paraqitja alternative grafike
9XX Të rezervuara që të modifikohen për nevojat e bibliotekës

Po ashtu, mund të tërheqim paralele sa i përket llojit të informacionit brena fushave 1XX, 4XX, dhe 7XX, të cilat ndihmojnë në identifikimin e përmbajtjes brenda fushave të autorizuara. Më poshtë po japim kuptimin e këtyre paraleleve që paraqiten me dy pozitat e fundit të tagut treshifror, me ca përjashtime aty këtu:

X00 Emra personal
X10 Emra të korporatave
X11 Emra të takimeve
X30 Tituj përmbledhës
X48 Terma që paraqesin kronologji
X50 Terma tematik
X51 Emra gjeografik
X55 Terma zhanri/forme

Grupet e fushave 1XX, 4XX, 5XX, dhe 7XX, si dhe ato me përmbajtje paralele, pjesë përbërëse të tyre, janë me rëndësi që të mbahen në mend gjatë punës me njësi të autorizuara. Ato mundësojnë që ta "parashikojmë" përmbajtjen e një fushe edhe nëse nuk e dimë saktësisht se çfarë përmban.

Pjesa V

A MUND T'I SHKËMBEJMË MES VETE NJËSITË E AUTORIZUARA NË FORMATIN MARC?

Ashtu siç mund të shkëmbehen njësitë bibliografike, bibliotekat i shkëmbejnë mes vete edhe njësitë e autorizuara që prej vitesh. Bibliotekat mund (dhe mund të mos) t'i krijojnë listat e tyre të njësive të autorizuara për emra dhe lëndë, por shumica e institucioneve që i kanë shkëmbyer përgjegjësitë e krijimit dhe mirëmbajtjes së listave të njësive të autorizuara, kanë përfunduar më një përfitim në çmim dhe me rritje të kualitetit. Të vepruarit në këtë mënyrë i parandalon bibliotekarët e ndryshëm që merren me njësitë e autorizuara të shpikin sërish atë që është shpikur më parë, pra të mos i krijojnë disa njësi të autorizuara për përcaktuesen e njëjtë, qoftë ajo emër, lëndë, etj. Programi i themeluar që herët NACO (Program bashkëpunimi për përcaktueset e emrave të autorizuara; në origjinal: Name Authority Cooperative) u bën të mundur institucioneve të ndihmojnë të ndërtojnë listën e autorizuar LCNAF. Për më shumë informacione për projektin NACO vizitoni faqen e Internetit: www.loc.gov/catdir/pcc.

Një program tjetër bashkëpunues, por "më i ri" është SACO (Program bashkëpunimi për përcaktueset lëndore të autorizuara; në origjinal: Subject Authority Cooperative Program). Ky program është krijuar për t'u ofruar bibliotekave një mjet përmes së cilit do të mund t'i propozojnë Bibliotekës së Kongresit përcaktues lëndorë si dhe numra të klasifikimit. Për më shumë informacione për projektin SACO, vizitoni faqen e Internetit: www.loc.gov.catdir/pcc.

Formati MARC 21 u mundëson bibliotekave të marrin pjesë në këto programe bashkëpunimi për katalogim, si dhe në të tjera, duke u ofruar një mjet standard për bartjen e informacioneve të njësive të autorizuara në një formë, të cilën e kupton kompjuteri. Po qe se formati MARC nuk do të ishte stabil, atëherë bibliotekat nuk do të mund t'i shkëmbenin njësitë e autorizuara, pa ndërhyrje, pasi sistemet e ndryshme të bibliotekave nuk do të mund të komunikonin ndërmjet vete. Formati MARC e parandalon këtë moskomunikim duke ofruar specifikacion teknik, që u mundësojnë bibliotekarëve, kompanive komerciale që merren me biblioteka – secilit – që merret me komunikimin e informacioneve të njësive të autorizuara, të komunikojnë mes vete. Po ashtu, formati MARC u mundëson kompanive komerciale, të cilat merren me sistemet e automatizuara bibliotekare, të krijojnë në atë mënyrë që do ta mund të marrë dhe përpunojë njësi standarde në formatin MARC.

Tash me siguri se jeni duke menduar se si mund të ofrojë specifikacione

teknike standarde formati MARC për të gjitha bibliotekat anë e mbarë botës. Biblioteka e Kongresit e boton dhe e mirëmban dokumentin *Specifikacionet e formati MARC 21 për strukturën e njësive, kombinimin e karaktereve dhe shkëmbim mediash* (në origjinal: MARC 21 Specifications for Record Structure, Character Sets, and Exchange Media) për t'u ndihmuar bibliotekave dhe institucioneve të tjera të cilat merren me krijimin dhe pranimin e njësive në MARC 21. Ky dokument ofron informacione teknike për strukturën e njësive në formatin MARC, kombinimi i karaktereve të përdorura në njësitë në formatin MARC, si dhe formatin për shpërndarjen e njësive të formatit MARC 21. Qëllimi i botimit të tij ka për synim personelin e përfshirë në dizajnimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve për shkëmbim dhe përpunim të njësive në formatin MARC.

Biblioteka e Kongresit shërben si agjenci për mirëmbajtjen e formateve MARC 21 për njësitë bibliografike dhe ato të autorizuara. Si pjesë të asaj përgjegjësie, biblioteka e Kongresit kujdeset për koordinimin e forumit për formatin MARC, që është një listë diskutimesh (marc@loc.gov) e cila shërben për diskutime të hapura dhe të ndryshme sa i përket ndryshimeve të propozuara si dhe çështjeve të tjera për përdoruesit e formatit MARC 21 në mbarë botën. Biblioteka e Kongresit si dhe Biblioteka Kombëtare e Kanadasë mbajnë takime të hapura për ndryshimet në formatet MARC 21.

Tash për tash në Shtetet e Bashkuara ekzistojnë dy grupe, të cilat janë përgjegjëse për rishikimin e ndryshimeve në dokumentacionin e formatit MARC 21: Komisioni për informacionet bibliografike të lexueshme nga makina (Machine-Readable Bibliographic Information Committee – MARBI) dhe Komisioni këshillues për formatin MARC (MARC Advisory Committee). MARBI është komision i Shoqatës së bibliotekave Amerikane (ALA) dhe përbëhet prej tre përfaqësuesve të secilit divizion të ALA-s: ALCTS (shërbimet teknike); LITA (automatizim); dhe RUSA (referencë). ALA përpiqet të sigurojë të gjitha llojet e përvojave që përfaqësohen në MARBI. Komisioni këshillues për formatin MARC është më i gjerë në përbërje dhe përbëhet prej përfaqësuesve të institucioneve dhe organizatave, të cilat e përdorin formatin MARC dhe marrin pjesë në zhvillimin e tij, të tilla si bibliotekat kombëtare, rrjetet bibliografike, grupet e kompanive komerciale për biblioteka, si dhe biblioteka e shoqata të tjera. MARBI takohet së bashku me Komisionin këshillues për formatit MARC në secilën konferencë të ALA-s (të cilat ndodhin në bazë vjetore si dhe kah mesi i dimrit). Veprimtaria kryesore e komisionit është të rishikojë punimet e ndryshme, të cilat flasin për propozimet për ndryshimet apo shtesat që i duhen bërë formateve ekzistuese MARC, të dorëzuara nga

dhe përmes Bibliotekës së Kongresit.

Atëherë kur paraqitet nevoja, Komisioni këshillues për formatin MARC krijon iniciativa mbështetëse të formatit MARC në fusha të reja. Vendimet për ndryshime bëhen me konsensus ndërmjet të gjitha palëve, të cilat i shqyrtojnë propozimet, e ndërsa përgjegjësia për pranim dhe implementim bie mbi bibliotekat kombëtare, si Biblioteka e Kongresit, Biblioteka Kombëtare e Kanadasë dhe Biblioteka e Britanisë së Madhe.

Siç mund ta shihni, bibliotekat individuale janë përfituese të drejtpërdrejta të gjithë kësaj pune standarde për formatin MARC 21. Pa të, bibliotekat nuk do kishin qenë në gjendja t'i shkëmbejnë njësitë e autorizuara me aq lehtësi dhe saktësi.

Pjesa VI

ÇËSHTJE LIDHUR ME TË DHËNAT NË FORMATIN MARC

Meqë teknologjia e kompjuterëve po përparon ditë e më shume, atëherë shtrohen një numër çështjes lidhur me cilësinë e të dhënave në bibliotekë dhe në sistemet e menaxhuar nga kompjuterët. Pra ju duhet të mbani një sy në këto çështje dhe rëndësinë e tyre për bibliotekën tuaj.

A. çështje sa u përket të dhënave: Me rastin e vlerësimit të njësive duhet t'i kemi në mendje një numër pyetjesh të rëndësishme: Ç*'cilësi kanë të dhënat në formatin MARC? Cilat fusha të formatit MARC 21 janë të pranishme? A janë të dhënat të krijuara në bazë të formatit MARC të Bibliotekës së Kongresit? Nëse po, a janë vënë informacione të mjaftueshme në atë njësi?A iu ka shtuar ndonjë gjë njësisë?*

Disa bibliotekarë kërkojnë nga kompanitë komerciale që merren me biblioteka për shembuj në letër të njësive të autorizuara që të mund t'i krahasojnë dhe të shohin se a përputhen ato me njësitë në formatin standard MARC 21.

Është e qartë se përmbajtja e njësive të autorizuara e përcakton edhe suksesin e një biblioteke në përpjekjet e saja në automatizim që njësitë e autorizuara të jenë të kontrolluara. Është me shumë rëndësi që të merren njësitë me cilësinë më të lartë që është e mundur.

B. Çështje sa i përket programit kompjuterik: Pyetjet me radhë që ka kuptim të kërkojmë përgjigje pas atyre më lartë janë: *A i shfrytëzon në maksimum informacionet në katalog sistemi i automatizuar bibliotekar të cilin e kemi zgjedhur? A i ruan të gjitha informacionet përfshirë edhe treguesit e përmbajtjes në formatin MARC 21?*

A i merr sistemi të gjithë informacionin e një njësie, pa ndonjë kufizim të paarsyeshëm apo fals në gjëra të tilla

